



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS
KËSHILLI DREJTUES**

Nr. 801 / prot. 3

Tiranë, më 26.5.2026

V E N D I M

Nr. 22, datë 26.5.2026

P Ë R

**MIRATIMIN E KËRKESËS SË Z. V K PËR VAZHDIMIN E
USHTRIMIT TË DETYRËS PAS PLOTËSIMIT TË MOSHËS SË PENSIONIT**

Në mbështetje të parashikimeve ligjore që rregullojnë statusin e pedagogëve të brendshëm të Shkollës së Magjistraturës, sipas të cilave ata gëzojnë të gjitha të drejtat dhe privilegjet e gjyqtarit të gjykatës së apelit, dispozitave të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, Këshilli Drejtues i mbledhur më datë 26 maj 2026,

V E N D O S I:

1. Të miratojë kërkesën e z. V K për vazhdimin e ushtrimit të detyrës edhe pas plotësimit të moshës së pensionit.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.